



# SBASHK

## Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures



# Arsimimi

## KULTURA E NJERIUT



*Ë-buletin*

**Janar, 2017**

Gatishmëri për të realizuar kërkesën e SBASHK-ut lidhur me Projektligjin për pagat


### Takim përmbajtësor me Ministrin Yagcilar



Duke vazhduar me përpjekjet që çështja e ngritur nga SBASHK-u lidhur me Projektligjin për pagat të ketë zgjidhje meritore, u zhvillua takimi me Ministrin e MAP, Mahir Yagcilar. Ky takim është zhvilluar në ambientet e Ministrisë së Administratës Publike dhe në të, përveç Ministrit të MAP, Mahir Yagcilar ishin edhe zv/Ministri në këtë Ministri, Hajredin Hyeseni dhe sekretari përgjithshëm, Arton Berisha, pastaj sekretari i përgjithshëm të MASHT, Alush Istogu, këshilltarët e Ministrit Bajrami ... (faqe 4)

Janari me shumë sfida e angazhime

### SBASHK-u kundërshtoi fuqishëm Projektligjin për pagat



Janari i sollti edhe një sfidë SBASHK-ut. Qeveria e Kosovës kishte miratuar Projektligjin për pagat dhe po përgatitej që ta ... (faqe 5)

Edhe një cikël i ri i takimeve dhe bashkëbisedave me anëtarësinë

### Gatishmëri dhe unitet për realizimin e detyrave konkrete



Me qëllim që të bashkëbisedojnë nga afër për sfidat dhe arritjet dhe për të marrë edhe ... (faqe 6)

SBASHK-u u takua me përfaqësuesin e lartë të “Olof Palme”

### Schmidt lavdëron arritjet e SBASHK-ut

Zyrtari i lartë i fondacionit “Olof Palme International” nga Suedia, z. Johan Schmidt i shoqëruar nga koordinatori ....(faqe 7)

Intervistë me drejtoreshën e shkollës “Kadri Bistrica” në Bistricë të Shalës znj.Ferdije Shabani

### Me vullnet të çeliktë tejkalohen sfidat e shumta

Ferdije Shabani udhëheq me sukses një vatër arsimore që punon në kushte të veçanta dhe që është përballur e përballet.... (faqe 3)



## Editorial

### Viti i zgjedhjeve në SBASHK



Të nderuar kolege e kolegë Këshilli Drejtues e ka shpallur vitin 2017 vit të zgjedhjeve në SBASHK. Po fillojmë me këtë aktivitet nëpër shoqata sindikale në të gjitha shkollat e Kosovës. Pastaj do të vazhdojmë me nivelet komunale e me nivelet arsimore në mënyrë që me forca të reja e me delegatë të zgjedhur nga ju të shkojmë në Kongresin e radhës në pjesën e parë të vitit 2018.

Të nderuar kolege e kolegë është ky moment i mirë që t'i qasemi me kujdes e seriozitet zgjedhjeve nëpër shoqata sindikale në të gjitha shkollat. Të angazhohemi që të zgjedhim kryetarë shoqatash njerëz që janë të gatshëm të angazhohen dhe që kanë

guxim të ngritin zërin kundër shkeljeve eventuale që do t'u bëhen kolegëve në shkollat e tyre. Nëse zgjedhim njerëz që duan të punojnë dhe që kanë guxim qytetar atëherë më lehtë do ta kemi t'i mbrojmë kolegët tanë sepse çështjet do të bëhen të ditura me kohë. Mos të harrojmë se suksesi i SBASHK-ut varet shumë nga puna e mirë dhe aktiviteti sindikal që bëhet nëpër shkolla. Nëse shoqatat sindikale i forcojmë edhe më shumë dhe janë aktive atëherë kjo do të reflektojë pozitivisht edhe në aktivitetin e suksesshëm në nivel komunal dhe në atë qendror. Për të qenë çdo gjë transparente dhe e saktë ne kemi punuar formular unik që do të plotësohen në çdo shkollë në mbyllje të takimeve zgjedhore të shoqatave. Formularët unik do të plotësohen edhe kur të mbahen Kuvendet zgjedhore në nivel të komunave. Zgjedhjet janë moment i mirë që t'i zgjedhim ata që na prezantojnë me guxim e argumente. Na qoftë i mbarë e i suksesshëm ky aktivitet.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë, mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazetën e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK)**  
përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.


Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel. +381(0)38/ 226 940



## Intervista

*Intervistë me drejtoreshën e shkollës “Kadri Bistrica” në Bistricë të Shalës znj.Ferdije Shabani*



### **Me vullnet të çeliktë tejkalohen sfidat e shumta**

*Ferdije Shabani udhëheq me sukses një vatër arsimore që punon në kushte të veçanta dhe që është përballur e përballlet me sfida të shumta. Kjo shkollë është në Veriun e Kosovës, konkretisht në Bistricë të Shalës. Në këtë*

*intervistë drejtoresha Voca flet pak , por tregon shumë për përkushtimin e mësimdhënësve e nxënësve në shkollën e saj , por na kujton edhe sfidat e shumta me të cilat ata përballën.*

Arsimimi sot:

### **Kush është Ferdiye Shabani?**

Ferdije

-Ferdie Voca Shabani është e lindur në Mitrovicë, më 28.01.1957 Fakultetin -Gjuhë dhe letërsi shqipe në Prishtinë. Si arsimtare e gjuhës shqipe ka punuar në Socanicë me paralele serbe, pastaj në Mitrovicë prapë si arsimtare e gjuhës shqipe në shkollën fillore ‘Nonda Bulka’ Ka punuar edhe në shkollën e mesme të muzikës Tefto Tashko’ si profesoreshë e gjuhës shqipe . Tani punon, në mandatin e dytë si drejtoreshë e shkollës fillore ‘Kadri Bistrica’ në Bistricë të Shalës.

Arsimimi sot:

### **Roli i drejtorit në shkollë në shërbim të arritjeve sa më të mëdha?**

Ferdije

Çdo punë e stafit , çdo aktivitet i nxënësve, drejtori është përgjegjës

Arsimimi sot:

### **Shkolla juaj përmendet për të mirë, cilat nga arritjet do të veçonit?**

Ferdije

Çdo lëndë përfaqësohet nga mësimdhënësit adekuat për atë edhe suksesi nuk mungon. Pasi që numri r i nxënësve nuk është i madh po ashtu edhe i stafit po

arrij të menaxhoj më lehtë , e kjo po ndikon në suksesin e shkollës dhe prandaj jam shumë e kënaqur.

Arsimimi sot:

### **Shkolla juaj punon e përcjell me plotë sfida, si i tejkaloni ato?**

Ferdije:

Si shumica e shkollave edhe shkolla jonë i ka sfidat dhe problemet e saj. Do të veçoja udhëtimin e nxënësve nga tri fshatrat ; Ceraj, Kushtovë dhe Bistricë Udhëtimi i tyre bëhet edhe më i vështirë kur bie borë e madhe. Problem është edhe udhëtimi i mësimdhënësve. Sfidë e madhe është edhe paraqitja e kohë pas kohe e bllokadave në rrugë nga një numër njerëzish të nacionalitetit serb. Mirëpo përgëzoj mësimdhënësit dhe nxënësit e shkollës sonë sepse ata vazhdojnë edhe për kundër gjithë këtyre vështirësive të angazhohen për dituri të reja .

Arsimimi sot:

### **Si e shihni angazhimin sindikal në shkollën tuaj?**

Ferdije:

Jemi falënderues për punën dhe angazhimin e tyre. Të gjithë angazhohemi në shërbim të dijes dhe arritjes së rezultateve sa më të mira. Në këtë intervistë dua të falënderoj edhe SBASHK-un që na dhuroi një makinë me të cilën e kemi vënë në shërbim të nxënësve dhe mësimdhënësve udhëtarë. SBASHK-u po dëshmohet vazhdimisht me punë të përkushtuar e angazhime dhe prandaj i përgëzoj dhe le të vazhdojnë edhe në të ardhmen kështu.

Arsimimi sot:

### **Çmoheni si drejtoreshë e suksesshme, si e arrini këtë?**

Ferdije

U jam mirënjohëse të gjithëve . Ata më respektojnë dhe më çmojnë dhe këtë respekt do ta ruaj duke qenë vazhdimisht në shkollë dhe bashkë me mësimdhënësit e nxënësit do të angazhohemi për arritje të reja.

Arsimimi sot:

**A keni ndonjë këshillë apo porosi për SBASHK-un ?**

Ferdije

Jemi falënderues dhe te kënaqur me punën dhe suksesin që po tregojnë.

Arsimimi sot:

**A e ka gjetur ende femra vetën në pozita vendimmarrëse?**

Ferdije

Femrat çdo herë po mundohen të marrin pjesë në pozita vendimmarrëse në arsim dhe janë shënuar arritje të mëdha, sidomos në arsim. Duhet vazhduar edhe në të ardhmen kështu.

Arsimimi sot:

**A keni diçka për të shtuar ?**

Ferdije

-Ju faleminderit.

## Gjatë muajit

*Gatishmëri për të realizuar kërkesën e SBASHK-ut lidhur me Projektligjin për pagat*

### Takim përmbajtësor me Ministrin Yagcilar

Duke vazhduar me përpjekjet që çështja e ngritur nga SBASHK-u lidhur me Projektligjin për pagat të ketë zgjidhje meritore, u zhvillua takimi me Ministrin e MAP, Mahir Yagcilar. Ky takim është zhvilluar në ambientet e Ministrisë së Administratës Publike dhe në të , përveç Ministrit të MAP, Mahir Yagcilar ishin edhe zv/Ministri në këtë Ministri, Hajredin Hyeseni dhe sekretari përgjithshëm, Arton Berisha, pastaj sekretari i përgjithshëm të MASHT, Alush Istogu, këshilltarët e Ministrit Bajrami, z. Azem Guri e Petrit Kelmendi.



Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj i ka treguar Ministrin Yagcilar për angazhimet e SBASHK-ut që përmes dialogut me institucionet të ndryshohet Projektligji për pagat ngase ai është degradues për profesionin e mësimit dhe ka kërkuar që profesioni i mësimit të rangohet në vend të merituar. Jasharaj edhe në këtë takim ka përsëritur qëndrimin e SBASHK-ut se nëse dialogu nuk jep rezultatet e pritura, atëherë do të ketë grevë të përgjithshme në të gjitha institucionet arsimore të Kosovës.

Ministri Yagcilar është shprehur se është i njoftuar me gjithë angazhimet e SBASHK-ut lidhur me këtë çështje dhe ka shprehur mirëkuptimin e tij dhe të Ministrisë që ai drejton lidhur me angazhimet dhe çështjet e ngritura nga SBASHK-u.



Edhe sekretari i përgjithshëm i MASHT, Alush Istogu bashkë me këshilltarin në këtë Ministri, Azem Guri kanë dhënë kontributin e tyre në emër të Ministrisë që përfaqësonin në përpjekjet e arritjes së marrëveshjes për ndryshimet në këtë Projektligj .Komisioni i MASHT dhe SBASHK janë takuar vazhdimisht dhe janë pajtuar me versionin e përbashkët lidhur me ndryshimet në Projektligjin për paga dhe të njëjtin ia kanë dërguar Kryeministrit Isa Mustafa, Kryetarit të Parlamentit, .Kadri veseli, Zv/Kryeministrit të Kosovës, z. Hajredin Kuçi dhe Ministrin Yagcilar.

Janari me shumë sfida e angazhime

## SBASHK-u kundërshtoi fuqishëm Projektligjin për pagat


Janari i solli edhe një sfidë SBASHK-ut. Qeveria e Kosovës kishte miratuar Projektligjin për pagat dhe po përgatitej që ta dërgonte drejt Parlamentit për miratim. SBASHK-u arriti të sigurojë tekstin e Projektligjit, tabelarin e gradimeve dhe një dokument tjetër përcjellës.



njëjtën kohë SBASHK-u informoi mësimdhënësit dhe opinionin në Kosovë se nëse këto angazhime që përmes dialogut të përmirësohet ky lëshim i madh nuk japin rezultate, atëherë SBASHK-u do të nis me grevën në të gjitha institucionet arsimore të Kosovës.



Kryesia dhe organet drejtuese të SBASHK-ut, duke analizuar projektligjin për Pagat që e ka miratuar Qeveria janë shokuar në nënçmimin dhe degradimin që ky projektligj pretendonte t'i bënte profesionit të mësimdhënësit duke e ranguar në të njëjtin pozicion në profesionet që kanë vetëm arsimim të mesëm. Nuk mungoi reagimi konkret dhe qëndrimi i SBASHK-ut kundër këtij projektligji dhe u bë publik në medie dhe në të njëjtën kohë u dërguan edhe shkresa në institucione, duke filluar nga Kryeministri, me reagimin e arsyeshëm e plot argumente të SBASHK-ut. U kërku nga Kryeministri Isa Mustafa dhe kabineti i tij qeveritar që ta rishikojë edhe një herë Projektligjin dhe shtojcën me tabelar të tij. Në të



Ky angazhim dha rezultate sepse Qeveria reflektoi dhe u nis me takimet. Fillimisht u zhvillua takimi me Ministrin Bajrami dhe kabinetin e tij. Në këtë takim u shtruan këto tema: Projektligji për pagat, Projektligji për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës nga viti shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99, Kontrata e re Kolektive e Arsimit të Kosovës, nevoja për angazhim të përbashkët për ngritjen e vazhdueshme të cilësisë në arsim, nevoja për ndryshimin e Udhëzimit Administrativ për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zv/drejtorëve në funksion të ngritjes së cilësisë në arsim, shkeljet që po bëjnë DKA-të gjatë përzgjedhjes së drejtorëve, zv/drejtorëve dhe kuadrot arsimor, bie fjala shpallja e konkurseve për vende pune në arsim pa caktuar shkollën dhe çështje të tjera. Pas prezantimit të kërkesave të shtruar në takim nga



herë Projektligjin dhe shtojcën me tabelar të tij. Në të

kryetari i SBASHK-ut, të dy palët janë pajtuar që të bëhen përpjekje të përbashkëta që të zgjidhen në mënyrë të drejtë gjithë këto çështje.

Në mbrojtje të kërkesave të anëtarësisë dhe në përpjekje për të vënë në vend të merituar profesionin e

mësimdhënësit në kuadër të ligjit të punës, SBASHK-u vazhdoi angazhimet dhe takimet me përfaqësues të Qeverisë.

## Edhe një cikël i ri i takimeve dhe bashkëbisedave me anëtarësinë **Gatishmëri dhe unitet për realizimin e detyrave konkrete**

Me qëllim që të bashkëbisedojnë nga afër për sfidat dhe arritjet dhe për të marrë edhe propozime e ide të reja për aktivitetin në vijim, SBASHK-u ka nisur ciklin e ri të vizitave nëpër komuna. Takimet e para të Kuvendeve janë mbajtur në Gjilan e në Mitrovicë. Në të dy këto takime është shprehur uniteti dhe gatishmëria për realizimin e detyrave konkrete në shërbim të anëtarësisë.



Kryetarët e Kuvendeve z.Blerim Mehmeti, Gjilan dhe znj.Vjollca Shala, Mitrovicë kanë njoftuar pjesëmarrësit në takime lidhur me angazhimet që duhet bërë pasi që viti 2017 është vit i zgjedhjeve në SBASHK duke filluar nga shoqatat sindikale. Në këto takime janë vlerësuar edhe arritjet e SBASHK-ut, por janë përmendur edhe sfidat aktuale dhe është thënë se me unitet e përkushtim këto sfida do të përballohen më lehtë dhe se do të shënohen arritje të reja në realizimin e kërkesave legjitime të SBASHK-ut. Duhet përmendur se këto takime ishin konceptuar të mbaheshin në formë të bashkëbisedës dhe kjo ka mundësuar që të gjithë pjesëmarrësit të jenë aktiv në diskutime, të shtrojnë pyetje, por edhe të ofrojnë ide për shumë çështje. Një pjesë të kohës në këto dy

takimeve pjesëmarrësit ia kanë kushtuar edhe angazhimeve të shtuara që duhet bërë në mënyrë që të përmirësohen rezultatet në PISA të radhës. Pjesë e kësaj përpjekjeje është edhe shpërndarja nëpër të gjitha shkollave e fletëpalosjeve dhe posterëve, që janë përgatitur falë bashkëpunimit me GIZ.



Në takimin e Kuvendit të SK të AF e AM të Gjilanit kanë marrë pjesë edhe kryetari i SBASHK-ut , Rrahman Jasharaj dhe menaxheri për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, të cilët kanë sjellë informacione të shumta dhe u janë përgjigjur shumë pyetjeve të pjesëmarrësve. Kjo agjendë e bashkëbisedave me anëtarësinë dhe me veprimtarët sindikalë do të vazhdojnë edhe nëpër komunat tjera të Kosovës. E veçanta e takimeve të radhës është se në Lipjan, Rahovec e Suharekë do të mbahen Kuvende zgjedhore .



Pjesëmarrësit në këto dy takime janë informuar nga afër për angazhimet e vazhdueshme të SBASHK-ut lidhur me çështjen e projektligjit për statusin e mësimdhënësve të Kosovës të viteve të 90-ta. Po ashtu është bashkëbiseduar edhe për veprimet e SBASHK-ut në kundërshtim të Projektligjit aktual për

paga dhe për Memorandumin e bashkëpunimit me BSPK-në, dhe është vlerësuar se ky angazhim është bërë me qëllim që të forcohet zëri sindikal në Kosovë. Takimet do të vazhdojnë edhe nëpër komunat tjera në frymën besimit të ndërsjellë dhe unitetit.

SBASHK-u u takua me përfaqësuesin e lartë të “Olof Palme”

## Schmidt lavdëron arritjet e SBASHK-ut

Zyrtari i lartë i fondacionit “Olof Palme International” nga Suedia, z. Johan Schmidt i shoqëruar nga koordinatori i këtij fondacioni për Kosovën, Levend Bicaku kanë vizituar selinë e SBASHK-ut dhe janë takuar me kryetarin Rrahman Jasharaj, nënkryetarin Lutfi Mani dhe me menaxherin për financa e administratë dhe këshilltar për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri.

Mysafiri nga Suedia ka shtruar shumë pyetje që lidheshin me organizmin sindikal në Kosovë dhe veçmas me angazhimet, arritjet dhe sfidat e SBASHK-ut. Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj dhe përfaqësuesit tjerë të kësaj sindikate i kanë informuar mysafirët për shumë angazhime dhe arritje të SBASHK-ut, duke mos harruar edhe sfidat dhe çështjet që ende nuk kanë marrë zgjidhje meritore. Edhe z. Schmidt edhe z. Bicaku janë shprehur se kanë dëgjuar për angazhimet e shumta të SBASHK-ut dhe

kanë përgëzuar këtë sindikatë për arritjet. Ata kanë shprehur interesimin që të shtohet bashkëpunimi i tyre me SBASHK-un dhe kanë përkrahur idenë që përfaqësues të Sindikatës së arsimit të Kosovës të vizitojnë Suedinë për të parë nga afër angazhimet e sindikatave atje dhe për të forcuar bashkëpunimin e për shkëmbyer ide e përvoja.

